



Prishtinë, 07 gusht 2024
Kodi i ZRRE-së: V_2316_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2557_06_24** i datës 11.06.2024;
- Ankesa e konsumatorit e datës 01.07.2024.

në seancën e mbajtur më datë 07 gusht 2024 nxori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** ankesa e konsumatorit **E.GJ** nga Komuna e Pejës, e parashtruar ndaj vendimit të DMK-së;
- II. MBETET** në fuqi, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRRE/DMK_V_2557_06_24 i datës 11.06.2024.
- III.** Vendimi nixirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit të tij nga Bordi i ZRRE-së, dhe i njëjti do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 11.06.2024 ka marrë Vendim me nr. ZRRE/DMK_V_2557_06_24 me të cilin e ka refuzuar ankesën e konsumatorit, përmes së cilës i kishte kontestuar faturat e energjisë elektrike, me njehsorin elektrik nr. 63982922 për shkak të dyshimit në lexim dhe faturim jo të saktë.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, konsumatori E.GJ brenda afatit ligjor ka paraqitur Ankesë në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Vvrtetim i gabuar dhe jo i plotw i gjendjes faktike dhe
- Zbatim i gabuar i sw drejtws materiale dhe procedurale.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 07.08.2024 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 01.07.2024; Vendimin e DMK ZRRE/DMK_V_2557_06_24 të datës 11.06.2024; Ankesën e konsumatorit në KESCO të datës 26.02.2024; Përgjigjen e KESCO-s të datës 20.03.2024, Ankesën e konsumatorit në DMK ZRrE-së të datës 05.04.2024; Rrjedhën e energjisë elektrike, Transaksionet dhe Listat e Leximit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit/konsumatorit **është e pabazuar**, sepse:

Departamenti i faturimit në KESCO me datë 26.02.2024 i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike për periudhën shkurt 2024 me **14,012 kWh** apo e shprehur në vlerë financiare prej **1,720.15 €**. Me datë 26.02.2024 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KESCO duke kërkuar që t'i behet ri shqyrtimi i faturës për periudhën shkurt 2024, për shkak të dyshimit në matje, leximit dhe faturimit jo të saktë të njehsori elektrik nr. 63982922. Me datë 20.03.2024 Departamenti për Konsumator në KESCO i është përgjigjur konsumatorit duke e aprovuar ankesën e tij bazuar në pasqyrën e rrjedhës së energjisë elektrike, transaksioneve si dhe listat e leximit.

Bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike si dhe listave të leximit, Bordi ka gjetur se, për disa periudha kohore, përgjatë viteve të ndryshme, në lista të leximit është evidentuar nga punëtorët e autorizuar të KEDS se nuk kanë qasje në pikën matëse, sugjerim për zhvendosje dhe se njehsori gjendet brenda. Një gjendje e tillë faktike, është në kundërshtim me nenin 25 – Qasja në pronë të konsumatorit – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, si vijon: *“Konsumatori është i obliguar që të ju lejojë qasje në pronën e tij, përfaqësuesve të Operatorit të Sistemit/Furnizuesit, për qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në Nenet 28, 29 dhe 30 të Ligjit për Energji”*. Pra, konsumatori ka vepruar në kundërshtim me këtë dispozitë ligjore, sepse është dashur që të iu lejojë qasje në pikën matëse punëtorëve të autorizuar të KEDS. Rrjedhimisht, edhe për periudhat dhjetor 2023 dhe janar 2024, punëtorët e autorizuar të KEDS kanë evidentuar që nuk kanë pasur qasje në pikën matëse të konsumatorit. Kësisoj, Bordi ka gjetur se, fatura e kontestuar nga konsumatori, e muajit shkurt 2024, nuk është faturim real për një muaj, por paraqet grumbullim të kWh, edhe për dy muajt paraprak, që konsumatori nuk ishte lexuar dhe ishte faturuar vetëm me taksa, në shumën prej 2.16 €.

Bordi, gjithashtu thekson se, pasi që janë analizuar me kujdes shpenzimet e konsumatorit, pajtohet me konstatimin e DMK-së se shpenzimet e konsumatorit të periudhës kontestuese edhe të viteve paraprake, ashtu që, shpenzimet e konsumatorit për periudhën **02/2023** janë **3,633 kWh**, për periudhën **01/2023** janë **4,536 kWh**, për periudhën **12/2022** janë **2,003 kWh**, për periudhën **02/2022** janë **4,156 kWh**, për periudhën **01/2022** janë **5,361 kWh**, për periudhën **12/2021** janë **3,168 kWh**. Pra, nga sa mund të shihet nga ky krahasim i shpenzimeve të konsumatorit, shpenzimet e tij për periudhat e dimrit janë të përafërta edhe në vitet paraprake, si me ato të periudhës kontestuese. Po ashtu, është e rëndësishme të theksohet se, punëtorët e autorizuar të KEDS, nuk kanë evidentuar që njehsori është me defekt apo se ka ndonjë parregullsi në matje.

Bordi e ka analizuar edhe Korrigjimin Financiar dhe ka gjetur se, Departamenti i faturimit në KESCO me datë 07.03.2024, përmes korrigjimit nr. 63673DPE-9051847 ka bërë korrigjimin në vlerë prej **-94.92 €** duke bërë shpërndarjen e kWh të faturuara për periudhën tre mujore, periudhën 12/2023 deri në



periudhën 02/2024, për shkak të faturimit pa matje. Bordi ka shqyrtuar korrigjimin e bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO dhe konstaton se KESCO ka vepruar konform nenit 28 paragrafit 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: *“Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”*, dhe se konsumatorit nuk i takon korrigjim tjetër financiar.

Ne ankesën e tij konsumatori po ashtu thekson se arsyeja mos faturimit te saktë është për shkak se lexuesi i KEDS-it nuk ka bere lexime, shkak mungesa e tij. Bordi ka shqyrtuar leximet e 10 shifrave te shtegut 503301 dhe ka gjetur se vetëm ne dy shifra nga totali nuk kane pasur lexim dhe se lexuesi është i njëjtë.

Tutje, Bordi thekson se, duke u bazuar në nenin 5 – Furnizimi me Energji elektrike – të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, të gjithë konsumatorët e kanë për obligim që të paguajnë për energjinë elektrike të shfrytëzuar sipas kontratës për furnizim me energji të lidhur me furnizuesin e energjisë, si dhe për tarifat për shfrytëzim të sistemit të miratuara nga ZRRE-ja”, andaj konsumatori e ka për obligim që të paguaj energjinë elektrike të cilën e ka shpenzuar.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose nga data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, Anëtare

Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare

Adnan Preniqi, Anëtar



Vendimi u dërgohet:

- KESCO-s,
- Konsumatorit **E.GJ** dhe
- Arkivit të ZRRE-së.